



FUTURE NARRATIVES

for Planet Earth

Për çfarë është Narrativat e së Ardhmes për Planetin Tokë?

Në kontesktin e Katastrofës Klimatike, projekti Narrativat e së Ardhmes për Planetin Tokë synon të rishqyrtojë marrëdhënien mes njeriut dhe natyrës dhe të ndryshojë mënyrën se si e perceptojmë atë sot. Përmes narrativave të reja në teatër, partneriteti ka për qëllim të rikthejë të ardhmen si një mundësi dhe si një praktikë. Sipas fjalëve të Donna Haraway, termi e ardhmja i referohet aftësisë dhe (siç e quan ajo) “aftësisë për përgjegjësi” për të imagjinuar rrëfime alternative. Në këtë kuptim, e ardhmja është diçka që mund të mësohet, por gjithashtu diçka që duhet praktikuar dhe ushqyer.

Për të arritur qëllimin e vet, projekti ka vendosur objektivat në vijim:

- Të zbatojë në mënyrë të qëndrueshme të menduarit ekologjik dhe të orientuar drejt së ardhmes në rutinat e përditshme të gjashtë institucioneve kulturore evropiane, përfshirë mënyrën e tyre artistike të të menduarit, metodat e prodhimit, modelet e (bashkë)prodhimit, planifikimin e burimeve dhe turnetë.
- Të krijojë një rrjet institucionesh kulturore, autorësh, teoricienësh dhe aktivistësh që janë të aftë jo vetëm të ndriçojnë në mënyrë kritike marrëdhënien mes njeriut dhe natyrës, por ta riformulojnë atë në thelb dhe ta vendosë në praktikë në mënyra të reja.
- Të nxisë tekste të reja dramatike, drama të reja dhe formate artistike që synojnë të promovojnë narrativa të tjera mbi marrëdhëniet mes njeriut dhe natyrës, njeriut dhe kafshës, si dhe njeriut me njeriun, përmes bashkëpunimeve, diskutimeve dhe angazhimit me organizata lokale të shoqërisë civile, si aktivistë, teoricienë dhe ekspertë.



Laboratorët Lokalë të Hulumtimit

Tre Labororë Lokalë Hulumtimi u organizuan nga secili partner dhe u zhvilluan nga prilli deri në maj 2024, përpara Konferencës së Parë në Palermo. Laboratorët krijuan bashkëpunim me mikro-partnerë lokalë (OJQ, artistë, aktivistë, teoricienë...) dhe mblodhën njohuri mbi një marrëdhënie të re mes njeriut dhe natyrës.

Me fjalët e Stijn Devillé:

"Të gjitha arritjet kryesore të njerëzimit dikur janë parë si utopi: e drejta për të votuar, puna 38 orë në javë, barazia mes burrit dhe gruas, heqja e skllavërisë, ndalimi i punës së fëmijëve, fundi i aparteidit, ndalimi i duhanit. Nuk të duhet shumica për të ndryshuar shoqërinë. Mjafton 3 deri në 5% e popullsisë për të mbjellë farën." (Stijn Devillé – në "Shpresë")

Konferencat ndërkombëtare & Festivalat

Një konferencë ndërkombëtare në Palermo nga 27 deri më 31 maj 2024, me pjesëmarrjen e të gjithë shtatë partnerëve dhe të ftuarve për të krijuar perspektiva të reja mbi marrëdhënien midis njeriut dhe natyrës. Një Laborator Kërkimor Artistik në Kopenhagë nga 11 deri më 15 shkurt 2025 për ekipet artistike të përzgjedhura. Një festival ndërkombëtar teatri në Graz gjatë Festivalit Ndërkombëtar të Dramaturgëve në vitin 2026; një Konferencë dhe Festival pesë-ditor për publikun, me pjesëmarrjen e të gjithë shtatë partnerëve dhe disa mikro-partnerëve për të paraqitur arritjet e të gjithë projektit, duke prezantuar të shtatë produksionet artistike, me ftesën e dhjetë ekspertëve ndërkombëtarë me mendësi të gjelbër dhe dhjetë mikro-partnerëve.





Projektet teatrore

Për të hapur rrugë të reja të të menduarit si për artistët e përfshirë ashtu edhe për publikun, do të krijohet MANIFESTI “Art – Njeri – Natyrë” për teatër dhe arte skenike të larmishme dhe të qëndrueshme, bazuar në rezultatet e laboratorëve. Ky manifest do të shërbejë si pikënisje për një thirrje për projekte artistike që përfshijnë: dramaturgë, producentë, artistë, aktivistë, shkencëtarë dhe mikro-partnerë të përzgjedhur. Kjo do t'i bëjë të arriturat e projektit të qasshme dhe do të komunikojë mënyrën e re të të menduarit tek artistë të tjerë, por edhe tek publiku.

Lansimi i një thirrje për artistë

Me produksionet që do të krijohen brenda kësaj thirrjeje për artistë, partneriteti synon të japë përgjigje për disa pyetje që lidhen me sfidat e mëdha që bota po përballet sot. Si duhet ta organizojmë shoqërinë? Si duhet të jetë marrëdhënia jonë me natyrën dhe me ekosistemin, pjesë e të cilit jemi vetëm një grimcë? Cilat narrativa na duhen për të qenë në gjendje të flasim për të ardhmen e planetit? Cilët zëra mungojnë në këtë bisedë dhe duhet të dëgjohen? Çfarë të ardhme mund të ëndërrojmë? Mund ta imagjinojmë?

Një libër pune

Për të hartuar të gjithë projektin: laboratorët kërkimorë, manifestin, shfaqjet, opinionet e publikut dhe përvojat nga punëtoritë.

FUTURE N
for
Plan



Partners



[UniT Graz](#)

Austri, Koordinator

HET NIEUWSTEDELIJK

[Het Nieuwstedelijk](#)

Belgijkë



[Theatre Bellevue](#)

Holandë

**qendra
multimedia**

[Qendra e Arteve Vizuele Multimedia](#)

Kosovë



[CESIE ETS](#)

Itali



[The Hessisches Landestheater Marburg GmbH](#)

Gjermani



[Mhtconsult](#)

[Danimarkë](#)



[**narrativesforearth.eu**](http://narrativesforearth.eu)



Project Number: 101128308



Co-funded by
the European Union

Funded by the European Union. Views and opinions expressed are however those of the author(s) only and do not necessarily reflect those of the European Union or the European Education and Culture Executive Agency (EACEA). Neither the European Union nor EACEA can be held responsible for them.